
 Republika e Kosovës <i>Republika Kosova Republic of Kosova</i>	DREJTORIA PËR PLANIFIKIM URBAN DHE MJEDIS		 Komuna e Istogut <i>Opstina Istog Municipality of Istog</i>
	Nr. 11-351-10/21	Dt. 05.02.2021	

Duke u bazuar në nenin 21 të Ligjit nr. 04/L-174 për Planifikimit Hapësinor, Ligjit të Ndërtimit Nr. 04/L-110 neni 18, Ligji i Procedurës së Përgjithshme Administrative Nr. 05/L-03 neni 21,22,44 dhe 84 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 20/21 qershor 2016), neni 17 pika d/, të Ligjit nr. 03/L-040 për vetëqeverisjen Lokale, Udhëzimit administrativ të MMPH - së nr. 06/2017 të dt 23.05.2017 për shqyrtimin e kërkesës për Kushtet e ndërtimit dhe Lejës së ndërtimit si dhe duke vendosur sipas kërkesës me nr. 11-351-3386 të datës 27.01.2021 nga Fondacioni Kosovar – Trashëgimia Kulturore pa Kufij (CHVB Kosovo), për lëshimin e Lejës ndërtimore për **Renovim të ndërtesë – Renovimi i kullës së Hamdi Halil Osmanaj në Trubohovc, Komuna Istog**, Drejtoria për Planifikim Urban dhe Mjedis, në procedurë administrative, merr këtë:

LEJE NDËRTIMORE RENOVIMI I KULLËS SË HAMDI HALIL OSMANAJ NË TRUBOHOVC

Drejtoria për Planifikim Urban dhe Mjedis pas shqyrtimit të kërkesës të **investitorit** Fondacioni Kosovar – Trashëgimia Kulturore pa Kufij (CHVB Kosovo) **dhe duke u bazuar në kërkesën nr. 11-351-3386 të datës 27.01.2021**, pala ka kërkuar **Renovim të ndërtesë – Renovimi i kullës së Hamdi Halil Osmanaj në Trubohovc, Komuna Istog** me të cilën kemi konstatuar se është e bazuar sipas Planit Zhvillimor Komunal të Istogut të aprovuar me datë 27.06.2019.

Investitorit Fondacioni Kosovar – Trashëgimia Kulturore pa Kufij (CHVB Kosovo), i lejohet **Renovim i ndërtesës të kullës së Hamdi Halil Osmanaj në Trubohovc, në parcelën nr. 00400-2 ZK Trubohovc, sipas Certifikatës pronësore me nr. 186/2021 ZK Trubohovc sipas projekt propozimit dhe projektit detal.**

Pjesë përbërëse e këtij aktvendimi është edhe dokumentacioni teknik që është marrë si bazë për lejimin e ndërtimit të objektit investues nga pika një e këtij Aktvendimi

Investitori lirohet nga taksat administrative, rregullores për Infrastrukturë 1/2020.

Investuesi është i obliguar:

- *Të siguroj shënimin e parcelës ndërtimore, vijës së rregullimit, nivelimit dhe vijës ndërtimore nga Drejtoria e Planifikimit urban dhe Mjedis*
- *Ta lajmëroj inspektorët ndërtimor pranë Drejtorisë për Inspektim për ditën e fillimit të punës së paku 8 ditë para fillimit të ndërtimit.*

- Pas kryerjes së objektit e më së voni në afat prej 30 ditësh ta paraqesë kërkesën për kontrollim teknik të objektit të përfunduar në mënyrë që të pajiset me leje për përdorimin e tij.
 - Të lejohen inspektorët që të verifikojnë gjatë ndërtimit ose në çdo kohë pas kryerjes së ndërtimit për objektin të cilin është dhënë leja e ndërtimit se ndërtimi është kryer në bazë të lejes së ndërtimit dhe kushteve urbanistike-teknike të caktuara.
- Kjo leje e ndërtimit vlen vetëm për ndërtimin e objektit investues **Renovim të ndërtesës – Renovimi i kullës së Hamdi Halil Osmanaj në Trubohovc, Komuna Istog.** Leja e ndërtimit është e vlefshme në periudhën për dy vjet nga dita e pranimit të aktvendimit.

A R S Y E T I M

Investitori Fondacioni Kosovar – Trashëgimia Kulturore pa Kufij (CHVB Kosovo) sipas kërkesës me nr. 11-351-3386 të datës 27.01.2021 i është drejtuar kësaj Drejtorie për dhëjen e Lejes ndërtimore të objektit investues- **Renovim të ndërtesës – Renovimi i kullës së Hamdi Halil Osmanaj në Trubohovc, Komuna Istog,** në parcelën nr. 00400-2 ZK Trubohovc, sipas Certifikatës pronësore me nr. 186/2021ZK Trubohovc, të përshkruar në pikën një të dispozitës të këtij Aktvendimi.

Bashkangjitur me kërkesën investitori ka paraqitur këtë dokumentacion:

- Projektin kryesor në pesë kopje identike.
- Provën mbi të drejtën e pronësisë apo shfrytëzim të parcelës nr. 00400-2 ZK Trubohovc, sipas Certifikatës pronësore me nr. 186/2021ZK Trubohovc
- Drejtorja e Planifikimit urban dhe Mjedis, duke shqyrtuar kërkesën dhe dokumentacionin tjetër të prezantuar, ka vërtetuar se investitori ka prezantuar tërë dokumentacionin e nevojshëm e të paraparë me rregullativin ligjor, nga lëmi i ndërtimit dhe se i njëjti është në harmoni me kushtet urbanistik-teknike dhe standardet tjera për llojin përkatës të ndërtimit, andaj u vendos si në dispozitiv të këtij Aktvendimi.

Udhëzim juridik: Pala e pakënaqur me këtë Përgjigje, përmes kësaj Drejtorie me ankesë mund t'i drejtohet MEA në Prishtinë brenda afatit prej 30 ditëve duke llogaritur nga dita e marrjes në dorëzim të këtij vendimi.

I dorëzohet: Investitorit, Drejtorisë për PUM dhe QSHQ për akivim

Urbanist
Ark. Rexhep Blakaj-id



Drejtori,
Jashar Blakaj idn

